



REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTES  
REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT  
REPUBLIKA KOSOVO - KANCELARIJA PREDSEDNICE

DEPARTAMENTI PËR SHËRBIME TË PËRBASHKËTA  
DEPARTMENT OF JOINT SERVICES  
ODELJENJE ZA ZAJEDNIČKE USLUGE

---

**KONKURS PUBLIK PËR ANGAZHIM TË PRAKTIKANTËVE ME PAGESË  
NË ZYRËN E PRESIDENTES SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

<b>Pozita:</b>	Praktikant
<b>Numri i pozitave:</b>	8 (tetë)
<b>Kohëzgjatja e praktikës:</b>	Gjashtë (6) muaj, me mundësi vazhdimi edhe gjashtë (6) muaj

**Detyrat kryesore:**

1. Detyrat kryesore të punës së praktikantit janë si në vijim:

- 1.1 angazhohet në mbështetjen e Kabinetit dhe të Administratës së Zyrës së Presidentes në fushën e protokollit, komunikimit, çështjeve juridike, administrative si dhe organizimin e aktiviteteve;
- 1.2 mbledh dhe studion literaturë përkatëse, informacione dhe dokumente sipas kërkesës nga Kabineti dhe Administrata e Zyrës së Presidentes;
- 1.3 përgatit draft-shkresa nën udhëheqjen e stafit të Zyrës së Presidentes;
- 1.4 ndihmon në mirëmbajtjen dhe përditësimin e bazës së të dhënave të aktiviteteve;
- 1.5 përkujdeset për arkivimin e dokumentacionit përkatës, skenimin, fotokopjimin dhe sistemimin e materialeve të nevojshme sipas kërkesës;
- 1.6 përkujdeset për pritjen dhe shoqërimin e mysafirëve;
- 1.7 kryen punë të tjera profesionale sipas kërkesës së Kabinetit të Presidentes, të Sekretarit të Zyrës së Presidentes apo Mbikëqyrësit të praktikantëve.

**Kualifikimet dhe aftësitë:**

Të drejtë aplikimi për pozitën e praktikantit kanë të gjithë kandidatët që:

- janë shtetas të Republikës së Kosovës;
- janë duke ndjekur vitin e tretë të studimeve në nivelin Bachelor ose studimet në nivelin Master, në fushat Juridik, Administratë Publike, Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, Shkenca shoqërore dhe të ngjashme;

- kanë aftësi të mirë të përdorimit të MS Office;
- kanë aftësi të mira të komunikimit dhe të gatishmëri për punë ekipore;
- kanë njohuri të gjuhës angleze;

### **Informata të përgjithshme për kandidatët:**

Shuma e kompensimit material të praktikantëve do të jetë ekuivalente me pagën minimale në Republikës e Kosovës në vitin e angazhimit të praktikantit;

Para kalimit të afatit kohor për të cilin janë pranuar në Presidencë, praktikantët pajisen me vërtetim/certifikatë me të cilin dëshmohet kryerja e suksesshme e punës praktike në Zyrën e Presidentes.

Zyra e Presidentes së Kosovës ofron mundësi të barabarta të angazhimit për gjithë kandidatët aplikues.

### **Procedura e konkurrimit:**

Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë formularin zyrtar të kërkesës për punë praktike (në vijim të kësaj shpallje), duke ia bashkëngjitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në fund të formularit dhe ta përcjellin nëpërmjet e-mailit, në adresën: [zprk@president-ksgov.net](mailto:zprk@president-ksgov.net)

Konkursi do të jetë i hapur 3 (tri) ditë nga dita e publikimit në ueb-faqen e Zyrës së Presidentes, duke filluar nga data 13.03.2023 deri më datën 15.03.2023.

**Data e fundit për pranimin e aplikacioneve është 15.03.2023, deri në ora 16.00.**

### **Shënim:**

Aplikacionet që arrijnë pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.